



Kufizimi i të drejtës së lëvizjes dhe lirisë ekonomike në raste të emergjencave civile

Dr. Myzafer ELEZI

Kolegji Universitar "Reald"

E-mail: myzafer.elezi@unireald.edu.al

Abstract

At all times the globe is threatened by large-scale natural disasters which constitute extraordinary events. These extraordinary and emergency events can be international, national or regional. They can be caused by ecological, technological, natural or human factors. The consequences can be great and immediate for people's lives and health, for wealth and the environment, disrupting the normal life of the community and causing catastrophes or critical situations. In order to cope with situations and prevent the consequences, as well as to solve the problems caused by it, it is necessary that the reaction of state structures and not only, in such situations be immediate and efficient.

This paper will address civil emergencies under Albanian law, their types, competencies for declaring a state of emergency and natural disasters, the limitation of the right to movement and economic freedom, and the obligation of the state to compensate for the consequences caused by these restrictions.

Key words: *civil emergency, natural disaster, prohibition, restriction, right of movement, etc.*

Abstrakt

Në çdo kohë globi është i kërcënuar nga fatkeqësi natyrore me përmasa të mëdha të cilat përbëjnë ngjarje të jashtëzakonshme. Këto ngjarjet të jashtëzakonshme dhe emergjente mund të jenë në nivel ndërkombëtar, kombëtar ose rajonal. Ato mund të shkaktohen nga faktorë ekologjik, teknologjik, natyror ose nga veprimet e njerëzve. Pasoja e ardhura mund të jenë të mëdha e të menjehershme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për pasurinë dhe ambientin, duke prishur normalitetin e jetës të komunitetit si dhe duke shkaktuar katastrofa apo situata kritike. Me qëllim përballimin e situatave dhe parandalimin e pasojave, si dhe zgjidhjen e problemeve të shkaktuara prej saj, nevojitet që reagimi i strukturave shtetërore dhe jo vetëm, në të tilla situata të jete i menjehershëm dhe efikas.

Në këtë punim do të trajtohen emergjencat civile sipas legjislacionit shqiptar, llojet e tyre, kompetencat për

shpalljen e gjendjes së emergjencës dhe fatkeqësive natyrore, kufizi i të drejtës së lëvizjes dhe lirisë ekonomike, si dhe detyrimi i shtetit për kompesimin e pasojave të shkaktuara nga këto kufizime.

Fjalë kyçe: *emergjencë civile, fatkeqësi natyrore, ndalim, kufizim, e drejtë e lëvizjes, etj.*

Emergjencat civile dhe llojet e tyre

"Emergjencë civile" është situata e papritur me pasojë negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Por, për të përcaktuar llojet e fatkeqësive, nevojitet një përkufizim i plotë se ç'shjtë fatkeqësia. Për këtë i referohemi ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", i cili, përcakton se, "Fatkeqësi" është ndërprerja serioze e çfarëdolloj shkalle e funksionimit të një komuniteti ose shoqërie për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit përballues, duke çuar në humbje të mundshme njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore. Gjithashtu ligji i sipërcituar njih dy lloje fatkeqësie:

- a. "Fatkeqësi natyrore", që janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.
- b. "Fatkeqësi të tjera", që janë aksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.¹

¹ Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 3.



Duhet theksuar se, emergjencat civile mund të jenë vendore, rajonale apo kombëtare ato mund të jenë edhe ndërkombëtare si në rastet e pandemive, etj. Emergjencat civile vendore mund të vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në një bashki dhe mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të saj, ndërsa ato rajonale vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në më shumë se një bashki që, për shkak të natyrës, shkallës dhe shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrjen e koordinuar të disa bashkive ose qarqeve. Kurse emergjenca civile kombëtare mund të vijnë si pasojë e fatkeqësive që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, qendrore e vendore, edhe me masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme.

Legjislacioni shqiptar për emergjencat civile

Shqipëria ka miratuar një serë aktesh ligjore e nënligjore që lidhen me fatkeqësitë natyrore, parandalimin dhe mbrojtjen e popullatës në raste të tilla, duke filluar nga ligji kryesor i shtetit që është Kushtetuta, ligji për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive, ligjin për mbrojtjen civile, etj. Më poshtë po citojmë disa nga parashikimet kryesore që lidhen me liritë dhe kufizimet e tyre në raste të emergjencave natyrore.

a. Kushtetuta e Shqipërisë. Lidhur me lirinë ekonomike, në nenin 11 të Kushtetutës parashikohet se: "Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike". Ndërsa në nenin 38, referuar lirisë së lëvizjes, Kushtetuta parashikon se: "Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit". Vlen të theksohet se, Kushtetuta në nenin 101 të saj i nje Këshillit të Ministrave të drejtën që, në rast nevojë dhe urgjence, përfshi emergjencat natyrore apo gjendjen e fatkeqësive natyrore, mund të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme.

b. Ligji nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe mbrojtjen e sëmundjeve invektive". Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksionet dhe sëmundjet infektive, duke përcaktuar rregullat dhe aktivitetet për zbulimin në kohë, evidentimin, parandalimin dhe kontrollin e tyre, për eliminimin dhe zhdukjen e sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë nga këto sëmundje.² Ndërsa objekti i tij është që, të përcaktojë përgjegjësitë dhe rolin e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të shëndetit publik, si dhe aktorëve të tjerë të të gjitha niveleve, publike e jopublike, në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit

² Neni 1 i Ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe mbrojtjen e sëmundjeve invektive".

dhe ndarjen e përgjegjësive për sëmundjet infektive dhe ngjarjet me rëndësi për shëndetin publik.

c. Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile". Qëllimi i këtij ligji është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Ky ligj rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.³

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe fatkeqësisë natyrore

Kompetencat për shpalljen e emergjencave civile dhe gjendjen e fatkeqësisë natyrore parashikohen në Kushtetutë dhe në ligjin për emergjencat civile. Në referim të nenit 174 të Kushtetutës, dhe të nenit 18 të Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Këshilli i Ministrave mund të shpallë gjendjen e emergjencës civile për 30 ditë. Përtej afatit 30 ditor, sipas po kësaj reference kushtetutese dhe ligjore, shtyrja e afatit bëhet vetëm me miratin nga Kuvendi. Sipas Kushtetutës, kompetencën për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme e ka Kuvendi. Në nenin 173 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë.
2. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme ndërhyrja e forcave të armatosura bëhet me vendim të Kuvendit dhe vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin.
3. Zgjatja e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë.

Ndërsa, kompetencën për shpalljen e fatkeqësisë natyrore e ka Këshilli i Ministrave. Lidhur me këtë kompetencë, Kushtetuta në nenin 174 parashikon se:

4. Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit.
5. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

Detyra e Këshillit të Ministrave në rastet e fatkeqësisë natyrore parashikohen në nenin 18 të ligjit për emergjencat civile, në të cilin citohet se ai ka këto përgjegjësi:

a. miraton Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Republikën e Shqipërisë;

³ Neni 1 i Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile".



b. miraton Planin Kombëtar për Emergjencat Civile;
c. miraton dokumentin e vlerësimit të riskut në nivel qendror;
d. mund të vendosë për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit;
e. informon Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrit për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon miratimin e Kuvendit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.
Gjithashtu në nenin 19, parashikohet se, për çdo rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Këshilli i Ministrave krijon Komitetin Ndërmnistror të Emergjencave Civile (KNEC), i cili është organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve materiale e financiare për përbalimin e fatkeqësisë natyrore.

Kufizimi i së drejtave dhe e drejta e kompesimit të shtetasve

Liria e lëvizjes është një e drejtë e garantuar në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, në nenin 45 të saj, lidhur me lirinë e lëvizjes parashikon se: *"Çdo shtetas i Bashkimit ka të drejtën të lëvizë dhe banojë lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare. Liria e lëvizjes dhe e vendbanimit mund t'u jepet, në përputhje me Traktatet, shtetasve të vendeve të treta me vendbanim të ligjshëm në territorin e një Shteti Anëtar"*⁴. Ndërsa, në nenin 38 të Kushtetutës së Shqipërisë parashikohet e drejta e lëvizjes së lirë, si një nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Gjithashtu, përpos garancive, Kushtetuta parashikon edhe rastet e heqjes apo të kufizimit të këtyre të drejtave. Kështu, në pikën 1 të nenit 27 të saj parashikohet se: "Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj". Ndërsa në pikën 2 të këtij neni, parashikohet se: "Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: a. kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b. për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c. kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; d. për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; e. kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë", etj.

Nga sa më lart, kuptohet qartë se, përpeç rasteve që lidhen me konsumim të veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, për të cilat kufizimet vendosen në vendim gjyqësor, e drejta e lëvizjes mund të kushtëzohet në raste të cilat lidhen me sigurinë dhe shëndetin publik. Gjithashtu, kufizimi i të drejtës së lëvizjes parashikohet

⁴ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, neni 45 - Liria e lëvizjes dhe e vendbanimit.

edhe në aktet ndërkombëtare, sic është edhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Europian, i cili në nenin 21 të tij parashikon se: *"Çdo qytetar i Bashkimit Europian, ka të drejtë të lëvizë dhe jetojë në mënyrë të lirë në të gjitha shtetet anëtare, duke marrë në konsideratë përjashtimet dhe kufizimet e vendosura nga kjo marrëveshje"*⁵. Mirëpo Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, pranon se kjo e drejtë mund të kushtëzohet për shkaqe të cilat lidhen me ekzistencën e një rreziku serioz të shëndetit publik.⁶ Sikurse e drejta e lëvizjes, edhe të drejtat dhe liritë ekonomike të shtetasve janë të garantuara me ligj. Në pikën 1 të nenit 11 të Kushtetutës, garantohet liria ekonomike: "Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike". Por, ato mund të kufizohen vetëm për arsye të rëndësishme me interes publik. Referuar pikës 3 të nenit 11 të Kushtetutës, citoj se "Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike".⁷ Pra, kufizimi i të drejtave në tërësi, dhe në veçanti i të drejtës së lëvizjes dhe lirisë ekonomike nuk mund të bëhen në asnjë formë tjetër, përveçse me ligj. Është e drejta e ekzekutivit që, në raste emergjente, të hartoj një draft-ligj të posaçëm apo akt normativ me fuqinë e ligjit, i cili të ligjitimohet nga legjislativi sa më parë të jetë e mundur, por jo më vonë se 45 ditë, siç parashikohet në Kushtetutë. Gjithashtu, kufizimet parashikohen edhe në ligjin nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe mbrojtjen e sëmundeve invektive", në të cilin Këshilli i Ministrave i njihen kompetencat për të kufizuar të drejtat kushtetuese të qytetarëve, të përcaktuara si masa të veçanta për parandalimin e sëmundjeve infektive janë:
a. zbulimi në kohë i burimit të infeksionit dhe rrugëve të marrjes e përhapjes së tij;
b. survejanca epidemiologjike dhe njoftimi i hershëm dhe i shpejtë;
c. izolimi dhe karantina;
d. transportimi i sigurt;
e. diagnoza e saktë dhe në kohë reale mikrobiologjike;
f. trajtimi dhe shërimi i personave të sëmurë;
g. gjurmimi i kontakteve me persona të infektuar apo të sëmurë;
h. aplikimi i detyruar i lëndëve biocide, sipas listës së sëmundjeve, të miratuar me urdhrë nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;
i. aplikimi i programeve të kontrollit të vektorëve;
j. mbikëqyrja shëndetësore e personave të punësuar dhe personave mbartës të mikrobeve;
k. kontrolli i infeksioneve në institucionet e kujdesit shëndetësor;
l. imunoprofilaksia, seroprofilaksia dhe kimioprofilaksia;
m. kontrolli i vektorëve, nëpërmjet produkteve biocide⁸, etj.

⁵ Traktati i Bashkimit Europian, neni 21.

⁶ Case C-326/07 Commission v Italy [2009] ECR I-2291 §69, 70.

⁷ Kushtetuta e Shqipërisë, neni 11, pika 1 dhe 3.

⁸ Ligji nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe mbrojtjen e sëmundeve invektive", neni 7, pika 1.



Ajo që duhet të kuptohet qartë, është ndryshimi i izolimit nga karantinimi. Ligji përkufizon qartë këto dy koncepte, duke sqaruar dhe subjektet të cilat i nënshtrohen këtyre masave kufizuese apo ndaluese. "Izolim" është izolimi i personave të dyshuar apo të mundshëm për prekje nga infeksione apo sëmundjet infektive, si dhe personave të infektuar nga të shëndetshmit, për të penguar përhapjen e infeksionit. Ndërsa "karantina" është kufizimi i lëvizjeve të njerëzve të shëndetshëm, të cilët kanë qenë në kontakt me të sëmurët ose burimin e infeksionit të sëmundjeve infektive të rrezikshme dhe qëndrimi i tyre në një mjedis të caktuar. Gjithashtu, ligji i sipërcituar parashikon se, për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive që kanë impakt në shëndetin e saj, ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton, me urdhër, masa të veçanta për mbrojtjen nga këto sëmundje, sipas udhëzimeve kombëtare, të përgatitura nga Instituti i Shëndetit Publik si më poshtë:

- a. mbyllja e shkollave;
- b. mbyllja e aktiviteteve jopublike apo publike;
- c. anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura;
- d. kufizimi apo ndalimi i lëvizjeve me mjetet e transportit publik;
- e. kufizimi i lëvizjeve brenda vendit".⁹

Ndërkohë që qytetarët dhe bizneset zbatojnë detyrimet e vendosura me ligj lidhur me kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe lirisë ekonomike, qeveria duhet të marrin masa të mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe bizneseve. Sipas ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", shteti është i detyruar të kompensojë të gjitha dëmet e ardhura si pasojë e kufizimeve nga gjendja e emergjencës, të tilla si: humbjet si pasojë e mbylljes së bizneseve, qerat, pagat e punonjësve, siguracionet, etj.¹⁰. Në përputhje me nenet 11, 27, 38 dhe 49 të Kushtetutës, si dhe neneve 19, 22 dhe 41 të Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", shteti ka detyrimin të ofrojë garanci sociale dhe ekonomike për shtetasit e vet. Kjo gjë arrihet duke implementuar paketë me lehtësira financiare në mbështetje të biznesit dhe qytetarëve, duke bërë që, pagesat për të sëmurët, për të karantinuarit, tatimet për bizneset, siguracionet, kreditë

⁹ Neni 7, pika 4 e ligjit të sipërcituar.

¹⁰ Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41 - "E drejta e kompensimit".

bankare, etj. , të mbulohen nga buxheti i shtetit.

Konkluzione dhe rekomandime:

Interesat jetike të qytetarëve, të tilla si, jeta, shëndeti dhe prona e qytetarëve, përbëjnë pjesën më themelore të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, të Republikës së Shqipërisë.

Në raste të fatkeqësive natyrore, të shkaktuara nga tërmetet, zjarri, përmytjet apo epidemitë ose pandemitë shëndetësore, qeveria dhe institucionet në vartësi të saj, kanë detyrimin ligjor të informimit të publikut për shkallën e rrezikut që i paraqitet vendit, masat e marra nga strukturat përgjegjëse për parandalimin, gjendjen reale të kapaciteteve dhe pajisjeve, për të reduktuar rrezikun dhe për t'u përballur me këtë epidemi mjekësore.

Në raste të fatkeqësive natyrore, institucionet shtetërore në inventarin e tyre logjistik, duhet të ketë pajisje moderne të mjaftueshme për personelin mjekësor, për personelin që shërben në të gjitha pikat e kalimit kufitar, si dhe ngritjen e kapaciteteve të domosdoshme të karantinave, për trajtimin e të infektuarëve, sipas udhëzimeve dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Në raste të fatkeqësive natyrore, Qeveria duhet të hartojë një plan kombëtar, të plotë, të integruar me masa të përshkallëzuara sipas shkallës së rrezikut, përfshi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme ose të fatkeqësive natyrore nëse situata mund të përshkallëzohet, marrjen e masave të menjëhershme lidhur me ndalimin e fluturimeve me vendet mbartëse, mbylljen e shkollave, grumbullimeve publike, si dhe realizimin e regjimit të karantinës për zonat dhe qytetarët që mund të infektohen. Të gjitha sa më lart, duhet të jenë në përputhje neneve 173 dhe 174 të Kushtetutës së Shqipërisë, në rast të kundër nuk kanë asnjë efekt ligjor.

Pas vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme ose fatkeqësive natyrore, me qëllim përballimin e situatës, përveç Policisë së Shtetit mund të angazhohet edhe Forcat e Armatosura, por ky veprim duhet të realizohet vetëm mbi bazën e neneve 173 dhe 174 të Kushtetutës si dhe mbi bazën e neneve 22 dhe 23 të ligjit nr. 59/2014, "Mbi pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të Forcave të Armatosura".

Referencat:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Traktati i Bashkimit Europian;
- Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian;
- Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile";
- Ligji nr. 59/2014, "Mbi pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të Forcave të Armatosura".
- Ligji nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe mbrojtjen e sëmundjeve invective";
- Case C-326/07 Commission v Italy [2009] ECR I-2291 §69, 70.